



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 16, datë 18.01.2012**

**MBI**

**SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË VLERËSUESIT TË PAVARUR**  
**Z. NUREDIN XHELILI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 146 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pasi mori në shqyrtim ankimin e vlerësuesit të pavarur Z. Nuredin Xhelili, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike,

**KONSTATOI, SE:**

Autoriteti ka licencuar si vlerësues dëmsh në sigurime Z. Nuredin Xhelili me licencën nr. 1, datë 10.07.2008.

Me Vendimin e Bordit nr. 165, datë 13.12.2011, është marrë masa administrative e tërheqjes së licencës. Ky vendim është marrë në përputhje me procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Z. Nuredin Xhelili ka depozituar në Autoritet ankimin administrativ ndaj këtij Vendimi.

Pretendimet e parashtruara nga Z. Nuredin Xhelili në ankimin administrativ, janë të pambështetura në ligj dhe në fakte, për arsye se në të gjitha konstatimet, për aktet e vlerësimit të kryera si rrjedhje e angazhimit të tij nga Gjykata në cilësinë e ekspertit, ka rezultuar se Z. Nuredin Xhelili ka shkelur legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Bordit Nr. 165, datë 13.12.2011 “Për marrjen e masës administrative ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime Nuredin Xhelili” dhe rrëzimin e ankimit të Z. Nuredin Xhelili.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

**NËNKRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**